



MODERNIZIMI I LINJËS SË 10-të HEKURUDHORE



***Fushë Kosovë
Korrik 2020***

Historiku i linjës së 10 hekurudhore

Njëri ndër projektet prioritare i INFRAKOS-it i cili ka rëndësi të veçantë për hekurudhën dhe po ashtu edhe për vendin tonë është Projekti i Rehabilitimit Gjeneral dhe Modernizimit të Linjës së 10 Hekurudhore. Linja e 10-të Hekurudhore i përket Rrjetit Kryesor Hekurudhor të Zgjerimit të Korridoreve të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T). Kjo linjë hekurudhore e lidhë Kosovën me Serbinë në veri dhe Maqedoninë e Veriut në Jug. Gjatësia e kësaj linje hekurudhore nga kufiri me Serbinë deri në kufirin me Maqedoninë e Veriut është 149.11 km

Nismat e realizimit të këtij projekti datojnë që nga viti 2010 kur mbështetur nga grantet e Bashkimit Evropian është bërë studimi i fizibilitetit për rehabilitimin gjeneral të kësaj linje hekurudhore.

Në gusht të vitit 2014 në konferencën e mbajtur në Berlin ndërmjet Komisionit Evropian dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë) është diskutuar dhe miratuar strategjia e zbatimit të agjendës së konektivitetit në fushën e transportit dhe energjisë e cila ka për detyrë që të bënë integrimin e vendeve të rajonit në këto dy fusha e pastaj edhe integrimin me vendet e BE-së.

Në këtë kontekst në vitin 2015, në zbatim të Agjendës së Konektivitetit, Komisioni Evropian rriti fokusin e vet duke i përcaktuar Rrjetet Kryesore të Transportit dhe Energjisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat do të jenë si zgjerim i Rrjetit Trans-Evropian e të cilat do të kenë përparësi për financim. Kështu KE-ja i ndau një miliard euro shtesë nga fondet e para-anëtarësimit në BE që së bashku me huat e partnerëve të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, këto fonde do të arrin vlerën e përgjithshme prej 4 miliardë euro investime në infrastrukturë dhe parashihet të krijojnë më shumë se 45000 vende pune në rajon.

Kështu që për zbatimin e Agjendës së Konektivitetit Komisioni Evropian për periudhën (2015 – 2019) për zbatimin e 32 projekteve të transportit dhe 7 projekteve të energjisë ka ndarë fonde në vlerë prej 880 milion euro në formë të granteve ndërsa 3.2 miliard euro janë siguruar nga huat e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në gusht të vitit 2015 në Konferencën e Vjenës është bërë përcaktimi i ndarjes së pakos së parë financiare për projektet e lartpërmendura, kështu që Kosova është njëra nga përfitueset e këtyre fondeve për projektin e Rehabilitimit Gjeneral dhe Modernizimit të Linjës së 10-të Hekurudhore.

Fillimi i zbatimit të projektit

Projekti i Rehabilitimit Gjeneral dhe Modernizimit të Linjës së 10-të Hekurudhore është i paraparë dhe do të realizohet në tri faza:

Faza 1: Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut - 66.622 km;

Faza 2: Fushë Kosovë – Mitrovicë - 34.369 km. dhe
 Faza 3: Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë - 48.119 km.

Sipas parashikimeve të para të bëra në vitin 2015 nga ekspertët e angazhuar nga Banka Evropiane e Investimeve kostoja e realizimit të këtij projekti është prezantuar në tabelën vijuese:

Kostoja e investimeve për projektin e rehabilitimit të Linjës së 10 Hekurudhore (Leshak - Fushë Kosovë - Hani i Elezit)				
Lloji i punëve	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
	Fushë Kosovë - Hani i Elezit	Fushë Kosovë - Mitrovicë	Mitrovicë – Leshak	
Punët e ndërtimit	69.9	31.2	43.8	144.9
Shërbimet				
- Plani dhe dizajni	2.1	0.9	1.3	4.3
- Mbikëqyrja	2.4	1	1.3	4.7
Ekspropriimi	0	0	0	0
Kostoja totale bazë	74.4	33.1	46.4	153.9
Kontigjenca teknike	14.9	6.6	9.3	30.8
Lëvizjet e çmimit	4.68	2.56	3.66	10.9
Kamata gjatë implementimit	5.5	3	4.3	12.8
Kostoja totale investive e projektit	99.48	45.26	63.66	208.4

Burimi i investimeve	Vlera në mil. Euro	Përqindja
Banka Evropiane e Investimeve	41.4	19.86
Banka Evropiane e Rindërtimit dhe Zhvillimit	39.9	19.15
Granti i BERZH-it	1.7	0.82
Granti i BE-së	79.8	38.29
Granti i WBIF-it	5.5	2.64
Qeveria e Kosovës	40.1	19.24
Totali	208.4	100

Themelimi i Njesisë për Implementimin e Projektit (PIU)

Mbështetur në Marrëveshjen Financiare të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime është paraparë krijimi i Njesisë për Implementimin e Projektit (PIU). Themelimi i kësaj njësie është paraparë po ashtu edhe me Manualin mbi Administrimin e Projektit i cili është hartuar nga

BEI-ja dhe është miratuar nga INFRAKOS-i në dhjetor të vitit 2015. Sipas Manualit mbi Administrimin e Projektit INFRAKOS-i do ta zbatojë projektin përmes Njesisë për Implementimin e Projektit (PIU). Drejtori i PIU do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për Implementimin e projektit dhe atë duke u mbështetur si në anëtarët e PIU-së, ashtu edhe ekspertët përkatës nga departamentet e ndryshme të INFRAKOS-it dhe entitetet e tjera qeveritare sipas nevojës.

PIU duhet të jetë e përbërë nga personeli i cili do t'i ketë të gjitha aftësitë e kërkuara teknike dhe financiare dhe do të jetë e autorizuar të veprojë në emër të Promotorit (INFRAKOS-it) për të gjitha çështjet brenda kontrollit dhe detyrimeve të Promotorit. Delegimi i kompetencave vendimmarrëse brenda Infracos përfshihet në një shtojcë të veçantë të Manualit, ndërsa termat e referencës për përzgjedhjen e asistencës teknike për mbështetje të PIU-së duhet me qenë të kënaqshme për BEI-në.

Andaj, bazuar në dy dokumentet e sipërpërmendura, PIU është themeluar me vendimin e KE-së me datën 26.11. 2015, ndërsa plotësim ndryshimi i PIU-së është bërë me vendimin e KE-së të datës 31.12.2018.

Vlen të përmendet se për hir të ngritjes së transparencës, qartësimi të përgjegjësive, ofrimit të informatave, ngritjes së cilësisë dhe performancës maksimale gjatë realizimit të projektit, INFRAKOS-i në bashkëpunim me asistencën teknike ka filluar të bënë hartimin e Rregullores mbi PIU-në përmes të cilës do të ndryshojë koncepti i deritanishëm i menaxhimit të Projektit duke i përcaktuar shumë qartë të gjitha përgjegjësitë e PIU-së dhe institucioneve tjera relevante drejt një zhvillimi të përsheptuar, kualiteti të lartë teknik dhe transparence të plotë për institucionet shtetërore dhe publikun e gjerë për këtë projekt të rëndësishëm së veçantë për INFRAKOS-in dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Rehabilitimi dhe modernizimi i fazës së parë të Linjës së 10-të (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)

Pas konferencës së Vjenës, INFRAKOS-i ka filluar bisedimet me dy institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH-in, BEI-në dhe WBIF-in) për financimin e këtij projekti. Pjesë e këtyre bisedimeve dhe vendimeve përfundimtare ka qenë edhe Qeveria e Kosovës e cila këtë projekt e ka cilësuar si njërin ndër projektet prioritare të infrastrukturës hekurudhore. Kështu që pas disa negociatave dhe bisedimeve është vendosur që të bëhet nënshkrimi i marrëveshjeve të huas me BERZH-in dhe BEI-në por edhe me Komisionin Evropian për marrjen e granteve për këtë linjë hekurudhore.

Në shtator të vitit 2015 është nënshkruar një marrëveshje financiare ndërmjet Ministrisë së Financave dhe BERZH-it, ndërsa marrëveshja për zbatimin e projektit është nënshkruar midis BERZH-it dhe INFRAKOS-it.

Në dhjetor të vitit 2015 është nënshkruar një marrëveshje financiare ndërmjet Ministrisë së Financave, BEI-së dhe INFRAKOS-it, ndërsa marrëveshja për zbatimin e projektit është nënshkruar ndërmjet BEI-së dhe INFRAKOS-it.

Në vitin 2016 është nënshkruar marrëveshja për dhurim financiar midis Ministrisë së Financave dhe Komisionit Evropian dhe atë:

- Kredi nga BERZH-i në vlerën prej 19,008,000.00 €
- Kredi nga BEI-ja në vlerën prej 22,492,000.00 €
- Granti nga BE / WBIF në vlerën prej 38,500,000.00 €

Projekti për fazën e parë ka filluar të realizohet edhe para nënshkrimit të marrëveshjeve financiare të përmendura më lartë dhe atë:

- Mbështetur nga BERZH-i në nëntor të vitit 2014 është bërë hartimi i Termave të Referencës për publikimin e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë hartimin e Projekt Dizajnit Detaj Teknik për Rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore;
- Publikimi i tenderit po ashtu është bërë në qershor të vitit 2014 ndërsa fondet për financimin e këtij projekt dizajni në vlerë prej 1,840,000.00 € janë siguruar nga BERZH-i në formë të granteve.

Projekt dizajni detaj teknik për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)

Publikimi për shprehje të interesit për Projekt Dizajn është bërë në faqen elektronike nga BERZH-i. Tenderi është vlerësuar në dy etapa: Në etapën e parë është bërë para-kualifikimi ku kanë konkurruar 19 (nëntëmbëdhjetë) kompani. Sipas rregullave të BERZH-it është dashur që të selektohen 6 (gjashtë) më te mirat të cilat i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara sipas Termave të Referencës. Kompanive të selektuara iu është kërkuar t'i dërgojnë ofertat teknike dhe financiare (pra ka qenë tender i hapur me dy zarfe).

Ofertat e tyre për këtë tender i kanë dorëzuar kompanitë vijuese:

1. 3TI Progetti Italia
2. ACCIONA Ingegneria, S.A.
3. ADT - OMEGA S.A.
4. AECOM INOCSA, S.L.U.
5. Ardanuy Ingegneria, S.A.
6. ARE - Austria Rail Engineering
7. DB International GmbH
8. Egis Rail S.A.
9. EPTISA Servicios de Ingegneria SL
10. Hill International N.V
11. iC consulenten Ziviltechniker GesmbH
12. International Technical Assistance
13. ITALFERR SPA
14. LOUIS BERGER
15. NET Engineering SpA

16. OBERMEYER HELLAS Ltd
17. Tecnimont Civil Construction S.p.A.
18. WYG International Limited (UK)
19. ZELJEZNICKO PROJEKTNO DRUSTVO d.d. (stock company)

Vlerësimi i kompanive është bërë nga komisioni i themeluar nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili sipas Manualit mbi Administrimin e Projektit është edhe në cilësinë e Drejtorit të Projektit. Vlerësimi teknik ka pasur 80% të pikëve, ndërsa 20% i ka pasur oferta financiare. Pasi që komisioni e ka kryer vlerësimin e të gjitha ofertave është vendosur që si kompani fituese të shpallet kompania "OBERMEYER HELLAS Ltd".

Vlera e ofertuar e kompanisë fituese ka qenë 1,762,860.00 €, Kontrata me këtë kompani është nënshkruar me datën 15 Korrik 2015, ndërsa afati i përfundimit të punëve është paraparë të bëhet me 31 Maj 2016. Mirëpo më vonë është bërë Amendamenti i kontratës me ç'rast përfundimi i punëve është shtyrë deri më 31 Dhjetor 2016.

Puna në realizimin e Projekt Dizajnit ka filluar në muajin gusht të vitit 2015 dhe ka vazhduar deri në momentin e kërkesës nga Komuna e Ferizajt për shqyrtimin e mundësive të futjes së Hekurudhës nënë dhe (kërkesë kjo e mbështetur edhe nga Ministria e Infrastrukturës). Kjo kërkesë ka shkaktuar një vonesë prej afro 6 Muaj. Po ashtu edhe vonesat nga komisionet e angazhuara për kontrollimin e drafteve të dorëzuara nga konsulenca kanë qenë një pengesë tjetër.

Me qenë se me projekt dizajn është tejkaluar shuma e paraparë për modernizimin e këtij segmenti të Linjës së 10-të hekurudhore, në pamundësi të transferimit të fondeve nga faza 2 dhe faza 3 në fazën 1, është vendosur që të bëhet ndryshimi i dosjes tenderuese ashtu që së pari të shkohet vetëm me punët ndërtimore (Civile) e pastaj të shkohet me tender të veçantë për ekzekutimin e punëve për sinjalizim dhe telekomunikim.

Në muajin Korrik të vitit 2017 nga PIU është aprovuar Dizajni Kryesorë Detal për punët ndërtimore dhe për pjesën më të madhe të Sinjalizimit dhe Telekomunikimit me Elektrifikim, Dizajni Softuerik (Logjik) dhe Dizajni Harduerik (Industrial) me ç'rast i është kërkuar punëkryesit që ta bëjë si Dizajnin Final dhe Dizajnin Ekzekutues.

Rehabilitimi gjeneral i fazës së parë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)

Bazuar në Dosje të Tenderit e cila është hartuar nga kompania OBERMEYER e cila e kishte realizuar Projekt Dizajnin Detaj Teknik për Fazën e parë si dhe pas aprovimit edhe nga BERZH-i, me datën 14 Maj të vitit 2018 në faqen elektronike të BERZH-it është bërë publikimi i tenderit për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë rehabilitimin gjeneral të fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore.

Për ekzekutim të punimeve tenderi është shpallur dy herë, shpallja e parë është anuluar si shkak i mos përbushjes së kushtit për 4 (katër) ofertues serioz dhe ndarja e dizajnit

Në tender kishin aplikuar 4 (katër) kompani:

1. GCF Generale Construzioni Ferroviarie Spa	Romë	Itali
2. Gülermak	Ankara	Turqi
3. TERNA SA	Athinë	Greqi
4. YAPI MERKEZI	Stamboll	Turqi

Vlera e kontratës ka qenë 80,000,000.00 € dhe komisioni vlerësues e ka përzgjedhur kompaninë fituese “Generale Construzioni Ferroviarie Spa” me të cilën është nënshkruar kontrata me 06.02.2019 me çmimin prej 78,625.639.40 €. Me nënshkrimin e kontratës me Kontraktorin (GCF) është paraparë sa vijon:

- Fillimi i punëve nga Kontraktori të filloj me 30.08.2019 dhe me qenë se është e paraparë që punët të kryhen për 730 ditë, atëherë del se projekti i rehabilitimit të fazës së parë duhet të kryhet deri më datën 29.08.2021.
- Është evidente se ka pasur ngecje në fillimin e punëve si për shkak të miratimit të programit të punëve, ashtu edhe për arsye tjera të cekura nga Kontraktori por të papranueshme për INFRAKOS-in;
- Me datën 27.09.2019 GCF e ka dërguar programin e punës për realizimin e punëve duke njoftuar se punët ndërtimore do të fillojnë me datën 08.01.2020
- Pas diskutimeve ndërmjet GCF – Kompanisë mbikëqyrëse HILL dhe PIU është pranuar versioni i 3 (tretë) i programit të punës i GCF-së
- GCF-ja më në fund ka njoftuar se punët për rehabilitimin do të fillojnë me datën 20.02.2020 dhe atë në stacionin hekurudhor të Miradisë.
- Me datën 14.03.2020 për shkak të pandemisë me COVID19, GCF ka njoftuar për suspendimin e punimeve deri në një njoftim të radhës;
- Me datën 05.05.2020 GCF ka rifilluar me punimet përkatësisht me shkarkimin e binarëve S49, traversave dhe materialit tjetër si dhe me rregullimin e platformës në stacionin e Miradisë.

INFRAKOS-i ka pasur disa konsultime me të gjitha palët e interesit përfshirë këtu (BERZH-in, BEI-në, GCF-në, HILL-in, Kompaninë konsulente EGIS dhe PIU-në) ku ka shprehur qartë pakënaqësinë me zhvillimet e deritanishme të këtij projekti i cili ka vonesa të mëdha në realizimin e tij. Për këtë arsye është kërkuar nga të gjitha palët e në veçanti nga Kontraktori GCF që të bëhet përsheptimi i punëve dhe shpërndarja e tyre në shumë fronte ashtu që të arrihet që punët të kryhen në afatin e paraparë.

Përzgjedhja e kompanisë mbikëqyrëse për fazën e parë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)

Hartimi dhe miratimi i termave të referencës për publikimin e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse është bërë nga BERZH-i dhe INFRAKOS-i dhe publikimi i tenderit është bërë me datën 18.05.2015 në faqen elektronike të BERZH-it. Vlera e paraparë për këtë kontratë ka qenë 1,400,000.00 €. Procesi i përzgjedhjes së kompanisë e cila do ta bënë mbikëqyrjen e punëve për fazën e parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) ka shkuar përmes tenderit t hapur me dy zarfe, zarfi teknik dhe ai financiar.

Në këtë tender kanë aplikuar kompanitë vijuese:

1. AECOM INOCSA / SPAIN
2. Ardany / Spain
3. CAF Transport Engineering/ Spain
4. Consulting Engineering Group Ltd/ Bulgaria
5. DB International GmbH / Germany
6. Egis International/ France
7. EPG Eisenbahn und Bauplanungsgesellschaft GmbH/ Germany
8. EPTISA / Serbia
9. Gauff GmbH&KG / Germany
10. Hill International N.V. / Netherlands
11. Ital Consult / Italy
12. Luis Berger / France
13. Roughton International / UK
14. TPF Spz / Poland
15. INCOSA / Spain

Pas vlerësimeve nga komisioni, për kryerjen e punëve të mbikëqyrjes është përzgjedhur kompania Hill International N.V. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Shërbime Kontraktuese është bërë me 31.01.2019. Data e Fillimit të punëve është 01.02.2019. Koha e Përfundimit 36 muaj, ndërsa Periudha e Njoftimit të Defekteve (DNP) 12 muaj. Vlera e kontratës është 1,399,970.00 € dhe fondet për këtë kontratë janë grant i WBIF-it.

Është paraqitur si problem mungesa edhe për 3 Ekspert Kryesor dy nga ta me kohë të caktuar dhe 1 tërë kohën deri në përfundim:

- Eksperti për tunele (pjesa më kritike e projektit), kohë e caktuar
- Eksperti i Gjeomekanikës (Prerjet e larta mbi 30 m), kohë e caktuar
- Eksperti i sasive i angazhuar deri në përfundim të projektit.

Kompania mbështetëse për Njësinë për Implementimin e Projektit (PIU)

Kjo kompani e bënë mbështetjen e PIU-së në të gjitha fazat e projektit, pra në fazën e parë dhe edhe në fazën e dytë deri në skadimin e kontratës së saj.

Tenderi është shpallur dy herë, herën e parë është anuluar për shkak se fituesi kompania konsulente Luis Berger gjatë negociimit të kontratës me kërkesë të BERZH-it për ndryshimin e përbërjes së stafit ngase Lider të ekipit kishte ofruar ekspertin me moshë të shtyrë. Nga BERZH-i iu është kërkuar që për arsye tjera ta ndërron ekipin pra duke e ruajtur parimin respektimin e politikave të saja për mundësi të barabarta. Këtë nuk e bëri Luis Berger dhe duke i kaluar të gjitha afatet dhe mos shprehjes së interesit të tenderuesve tjerë BERZH-i vendosi ta ri-përsëritë tenderin e hapur me dy zarfe, të kompetencës teknike dhe ofertës financiare.

Publikimi i tenderit është bërë në faqen elektronike të BERZH-it për herë të parë me datën 22.07.2015, ndërsa për herë të dytë me 07.06.2019.

Në këtë tender kanë aplikuar kompanitë vijuese:

1. AECOM INOCSA, S.L.U. / Spain
2. Ardanuy Ingenieria, S.A. / Spain
3. Egis International / France
4. iC consulenten Ziviltechniker GesmbH / Austria
5. ITALFERR SPA / Italy
6. Louis Berger / France

Pas vlerësimit të ofertave, komisioni vlerësues ka bërë përzgjedhjen e kompanisë fituese “EGIS International”

Vlera e paraparë për këtë kontratë është 600,000.00 €, Kontrata është nënshkruar me 23.01.2020 në vlerën prej 599,940.00€, mjetet janë grant i BERZH-it, ndërsa kohëzgjatja është deri më datën 22.01.2023.

Projekt dizajni detaj teknik për rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Publikimi për shprehje të interesit për Projekt Dizajn është bërë në faqen elektronike nga BERZH-i me datën 05.07.2016.

Ofertat e tyre për këtë tender i kanë dorëzuar kompanitë vijuese:

- | | |
|------------------------|---------------------|
| 1. 3TI Progetti Italia | 11. Ingerop |
| 2. Antea Nederlands | 12. Institut IGH DD |
| 3. Ardanuy Bernard | 13. Ital Ferr |
| 4. Ingenieure | 14. Obermeyer |
| 5. DB Engineering | 15. PGlobal |
| 6. DAG Energetika | 16. Prisma Consult |
| 7. Egis | 17. Sintagma |
| 8. Gauff | 18. Typsa |
| 9. Eptisa | 19. Systra |
| 10. IDOM | |

Vlera e projektit është 1,000,000.00 €, ndërsa vlerësimi i kompanive është bërë nga komisioni i themeluar nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili pasi që e ka kryer vlerësimin e të gjitha ofertave është vendosur që si kompani fituese të shpallet kompania “OBERMEYER HELLAS Ltd”.

Vlera e ofertuar e kompanisë fituese ka qenë 905,432.00 €, Kontrata me këtë kompani është nënshkruar me datën 30 Prill 2018, ndërsa afati i përfundimit të punëve është paraparë të bëhet me 30 Janar 2019. Përfundimi i punëve për këtë Projekt dizajn është bërë me datën 17.02.2020.

Në raportin fillestar PIU e mbështetur nga grupet e punës ka vendosur që ky projekt dizajn të jetë në analogji me dizajnin e fazës së parë nga se pas ndarjes së fazës së parë ishte vendosur që tenderi i veçantë për sinjalizim dhe telekomunikim të përfshijë fazën e parë dhe fazën e dytë.

Rehabilitimi gjeneral i fazës së dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Ngjashëm sikurse me fazën e parë procesi i përzgjedhjes së kompanisë e cila do ta bënë rehabilitimin gjeneral të fazës së dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë) është bërë përmes të tenderit të hapur në një Etapë, me parakualifikim, me vlerësim teknik dhe ofertën financiare, pra me dy zarfe.

Publikimi i tenderit është bërë në faqen elektronike të BERZH-it përmes procesit të prokurimi elektronik me datën 20.02.2019 për parakualifikim, ndërsa me datën 31.03.2020 për oferta teknike dhe financiare.

Në këtë tender kanë aplikuar kompanitë vijuese:

1. GCF-Itali,
2. INC SPA- Itali
3. OZALTIN Consorcium – Turkey
4. SALLAHU / Kosovë
5. TERNA / Greece,
6. TRACE Group Kold PLC / Bulgaria
7. YAPI Merkezi / Turkey

Komisioni i ekspertëve ë mbështetje të kompanisë konsulente mbështetëse të PIU-së është duke e bërë vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare të kompanive të cilat kanë aplikuar dhe në momentin e përfundimit të vlerësimit pritet që të bëhet shpallja e kompanisë fituese dhe më pastaj të bëhet nënshkrimi i kontratës.

Përzgjedhja e kompanisë mbikëqyrëse për fazën e dytë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

INFRAKOS-i është duke e bërë hartimin e termave të referencës për publikimin e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse për fazën e dytë të Linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë). Ky proces pritet që të përfundojë brenda këtij viti së bashku edhe me përzgjedhjen e kompanisë punëkryese për këtë fazë.

Përzgjedhja e kompanisë mbikëqyrëse për realizimin e Projektit të rehabilitimit dhe modernizimit për fazën e dytë do të bëhet para se të bëhet përzgjedhja, respektivisht nënshkrimi i kontratës për rehabilitimin e këtij segmenti hekurudhor. Pra është tepër e rëndësishme që së pari të bëhet përzgjedhja e kompanisë mbikëqyrëse e tek pastaj e kompanisë për ekzekutimin e punëve.

Përzgjedhja e kompanisë për rehabilitimin e sinjalizimit dhe telekomit për fazën e parë dhe të dytë të Linjës së 10 Hekurudhore (Mitrovicë - Fushë Kosovë – Hani i Elezit)

Kompania projektuese Obermeyer Hellas L.T.D në përputhje me kontratën për dizajnin e fazës së parë Fushë Kosovë – Hani i Elezit, përveç dizajnit për punë ndërtimore ka kryer edhe dizajnin për Sinjalizim, Telekomunikim si dhe për Elektrifikim, kështu që dizajnin për fazën e parë e kemi të punuar dhe të aprovuar me vërejtje të cilat është kërkuar të inkorporohen në dokumentin final. Me ndarjen e projektit të njëjtat vërejtje është kërkuar që të përmirësohen në fuzionimin ose dokumentin unik i cili përfshinë të dyja fazat.

Po ashtu edhe për fazën e dytë për segmentin Fushë Kosovë - Mitrovicë në të njëjtën mënyrë është realizuar dizajni për punët ndërtimore dhe për Sinjalizim, Telekomunikim dhe Elektrifikim. Me këtë, pas inkorporimit të të gjitha komenteve të grupit punues përkatës ka përfunduar dizajni i fazës së dytë. Me unifikimin e projektit përkatësisht fazës 1 dhe fazës 2 atëherë grupi punues ka dhënë komente të cilat kanë qenë pezull nga faza e parë dhe të njëjtat janë pranuar nga kompania hartuese e dizajnit dhe pritet që të bëhet inkorporimi i të njëjtave në projekt dizajn në mënyrë që pastaj të bëhet kontrollimi dhe aprovimi i dizajnit final.

Më pas do të hapet rruga për përpilimin e tender dokumentit im cili do të publikohet në ecepp-ebrd (ueb faqja elektronike e BERZH-it).

Projekt dizajni detaj teknik për rehabilitimin e fazës së tretë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Mitrovicë – Leshak)

Ky projekt dizajn do të realizohet nga WBIF-i përmes IPF 9 dhe me datën 04.06.2020 është mbajtur një video konferencë me përfaqësuesit e WBIF-it në të cilën është diskutuar mënyra e realizimit të këtij projekt dizajni.

INFRAKOS-i ka shprehë qëndrimin se ky projekt dizajn duhet përveç punëve ndërtimore të përfshijë edhe pjesën e sinjalizimit dhe telekomit. Për momentin janë duke u mbledhur informatat e nevojshme nga WBIF për hartimin e Termave të Referencës për publikimin e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë projekt dizajnin detaj teknik.

Përfundim

Sipas parashikimeve tona realizimi i tërësishëm i rehabilitimit gjeneral dhe modernizimit të Linjës së 10-të Hekurudhore pritet të kryhet në vitin 2024/2025 me ç'rast Kosova do të ketë një linjë hekurudhore e cila i plotëson të gjitha kërkesat e interoperabilitetit të përcaktuara sipas direktivave të BE-së, linjë kjo nëpër të cilën do të zhvillohet qarkullimi i trenave me një shpejtësi prej 80 km / h deri në 120 km / h dhe e cila do ta lidhë Kosovën me dy vendet e rajonit dhe përmes tyre edhe me vendet e BE-së.

Publikimi i kësaj informate në ueb faqen e kompanisë tregon përkushtimin e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të INFRAKOS-it për një transparencë maksimale në veprimin e tyre karshi institucioneve shtetërore dhe publikut të gjerë. Informata mbi Rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore do të azhurnohet në mënyrë kontinueale ashtu që lexuesi të ketë informatë të qartë mbi zhvillimet më të reja për këtë projekt të interesit të veçantë për INFRAKOS-in por edhe për shtetin tonë.

Pra qasja e BD dhe Menaxhmentit për këtë projekt por edhe për të gjitha veprimet tjera brenda kompanisë është dhe do të jetë plotësisht transparente për të gjitha palët e interesit dhe publikun e gjerë.